



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e enjte, në datën 28 korrik 2022, në mënyrë hibride, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, AMA dhe mjeteve të komunikimit në distancë, (platformës zoom), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Armela</b>	<b>KRASNIQI</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Desada</b>	<b>METAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Aurela</b>	<b>BICJA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Besian</b>	<b>ZOGAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gjergji</b>	<b>HAMITI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Jetmir</b>	<b>HALILAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Joana</b>	<b>ALLUSHI</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Ndëshkimin e shoqërisë “Top Channel” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat kombëtar “TV Top Channel”, me sanksion gjobë në masën 200 000 (dyqindmijë) lekë”, mbi shkelje të ligjit nr. 97/2013, për mediat audiovizive, të ndryshuar, nenet 4, 32 dhe 33 të tij, për përmbajtje që justifikojnë dhunën dhe diskriminimin. (**Vendimi nr. 90, datë 28.07.2022**)
2. Rinovimin e licencës së shoqatës “Radio Maria”, për subjektin audio të komunitetit “Radio Maria” dhe ndryshimin e kushteve teknike të saj. (**Vendimi nr. 91, datë 28.07.2022**)
3. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Eneritan Pupa, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Pupa”. (**Vendimi nr. 92, datë 28.07.2022**)
4. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Adriatik Bajrami, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor Delvina”. (**Vendimi nr. 93, datë 28.07.2022**)
5. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “TV Best Channel” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Kabllor 2ASL”. (**Vendimi nr. 94, datë 28.07.2022**).

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 28 korrik 2022**